



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2017, miratoi këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL TË VEPRIMIT PËR TË ZHVENDOSURIT DHE
ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME

Neni 1

Miratohet Vendimi për Planin komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Neni 2

Ky plan veprimi ka për qëllim ta ndihmojë Komunën në përmbushjen e obligimeve të veta në lidhje me procesin e kthimit dhe të riintegritimit të personave të zhvendosur, në bazë të kërkesës për asistencë për kthim vullnetar dhe vlerësimin të nevojave specifike sipas sistemit të menaxhimit të të dhënave.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe organet kompetente të Administratës komunale.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 561/02-0182389/17, më 26.07.2017.



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi /jur. i dipl.